



Problema me 3 pikë



1. Kristina filloi të vizatonte një mace. shumë detaje. Cilën nga figurat ka vizatuar ajo?


Ajo e përfundoi vizatimin duke shtuar më



2. Në lashtësi populli Maja përdorte simbolet "pikë" dhe "vijë" për të shkruar numrat. Një pikë paraqiste numrin 1 dhe një vijë paraqiste numrin 5. Si e shkruanin ata numrin 17?





3. Një orë dixhitale tregon kohën 20:19. Sa do të tregojë ora momentin më të parë i cili shprehet me të njëjtat shifra?







4. Në një kopësht ka 14 vajza dhe 12 djem. Nëse gjysma e fëmijëve vendosin të shkojnë për një shëtitje, të paktën sa prej tyre do të jenë vajza?



- (A) 5 (B) 4 (C) 3 (D) 2 (E) 1

5. Shuma e pikëve në faqet e kundërta të një zari të rregullt është 7. Cila nga figurat tregon një zar të rregullt?



6. Cila nga figurat gjeometrike në vijim nuk bën pjesë në këtë figurë?



7. Laura dëshironte të ngjyroshte një katror 2×2  të kësaj figure . Sa mundësi zgjedhjeje kishte ajo?

- (A) 5 (B) 6 (C) 7 (D) 8 (E) 9






8. Gjashtë numrat e parë natyrorë tek janë vendosur në faqet e një zari. Toni e hodhi zarin tri herë. Cili nga numrat në vijim nuk mund të jetë shuma e tre hedhjeve të Tomit?

- (A) 21 (B) 3 (C) 20 (D) 19 (E) 29

9. Shuma e moshave të një grupi kangurësh është 36. Pas dy vjetësh kjo shumë do të jetë 60 . Sa është numri i kangurëve në këtë grup?


- (A) 10 (B) 12 (C) 15 (D) 20 (E) 24

10. Mikeli ngjyrosi secilin nga trupat e mëposhtëm. Trupat janë formuar nga kuba njësi identikë. Bazat e tyre formohen prej 8 kubash. Për cilin trup është përdorur më shumë bojë gjatë lyerjes?



Problema me 4 pikë

11. Në secilën prej tre copave të letres është shkruar nga një numër treshifror. Dy nga shifrat janë të mbuluara. Nëse dihet që shuma e tre numrave është 826, sa është shuma e dy shifrave të mbuluara?




- (A) 7 (B) 8 (C) 9 (D) 10 (E) 11

12. Bretkosa Meri zakonisht ha 5 merimanga në ditë. Në ditët kur ajo është shumë e uritur, ha 10 merimanga. Në 9 ditët e fundit ajo ka ngrënë 60 merimanga. Në sa ditë ka qenë shumë e uritur bretkosa Meri?

- (A) 1 (B) 2 (C) 3 (D) 6 (E) 9

13. Albani luan me një zinxhir të përbërë prej 10 hallkash (si në figurë). Cilën nga figurat e mëposhtme nuk mund të formojë Albani?




- (A) (B) (C) (D) (E)

14. Pesë katrorë të njëjtë janë ndarë në katrorë më të vegjël. Cili nga katrorët ka sipërfaqen më të madhe me ngjyrë të zezë?

- (A) (B) (C) (D) (E)

15. Një trekëndësh i madh barabrinjë është ndarë në trekëndësha më të vegjël barabrinjës, siç tregohet në figurë. Brinja e trekëndëshit të vogël gri është 1 m. Sa është perimetri i trekëndëshit të




- (A) 15 m (B) 17 m (C) 18 m (D) 20 m (E) 21 m

16. Në kopshtin e një magjistareje ndodhen 30 kafshë: qen, mace dhe minj. Magjistarja shndërroi 6 qen në mace. Pastaj shndërroi 5 mace në minj. Tani në kopsht ajo ka numër të njëjtë macesh, qensh dhe minjsh. Sa mace kishte ajo në fillim?


- (A) 4 (B) 5 (C) 9 (D) 10 (E) 11

17. Me blloqe me përmasa $1\text{ cm} \times 1\text{ cm} \times 2\text{ cm}$, mund të ndërtohen kulla, siç tregohet në figurë. Sa e lartë është kulla që ndërtohet me të njëjtën mënyrë me 28 blloqe?



- (A) 9cm (B) 11cm (C) 12cm (D) 14cm (E) 17cm

18. Moza palosi një copë letre katrore dy herë dhe më pas e preu me gërshtë dy herë, siç tregohet në figurë. Sa copa letre do të ketë pas prerjeve Moza?




- (A) 6 (B) 8 (C) 9 (D) 12 (E) 16

19. Aleks, Beni dhe Koli dalin për shëtitje çdo ditë. Nëse Aleks nuk vendos kapele, atëherë kapelen e vendos Beni. Nëse Beni nuk vendos kapele, atëherë Koli vendos kapele. Sot Beni nuk ka vendosur kapele. Kush nga shokët ka vendosur kapele?


- (A) Të dy, Aleks dhe Koli (B) Vetëm Aleks
(C) Vetëm Koli (D) As Aleks, as Koli
(E) Nuk është e mundur të përcaktohet me saktësi

20. Secila nga figurat e mëposhtme paraqet një kub të hapur. Vetëm njëra prej tyre do të formojë një vijë të pandërprerë, kur formohet kubi. Cila është figura e duhur?



Problema me 5 pikë


21. Kubi i paraqitur në figurë ka në çdo faqe të tij të shënuar një numër natyror.



Prodhimi i numrave në faqet e kundërta është i njëjtë. Sa është shuma më e vogël e mundshme e të gjashtë numrave të shkruar në faqet e kubit?

- (A) 36 (B) 37 (C) 41 (D) 44 (E) 60

22. Gjashtë sfera të zeza të njëjta dhe tre sfera të bardha të njëjta janë shpërndarë në anët e dy peshoreve të baraspeshuara, siç tregohet në figurë.




Sa është pesha përgjithshme e të nëntë sferave?

- (A) 100 g (B) 99 g (C) 96 g (D) 94 g (E) 90 g

23. Roberti shkruajti në fletore 5 fjalitë e mëposhtme, nga (A) në (E). Vetëm njëra prej tyre është e gabuar. Cila është fjalia e gabuar?

- (A) Djali im Berti ka 3 motra. (B) Vajza ime Ana ka dy vëllezër.
 (C) Vajza ime Ana ka dy motra. (D) Djali im Berti ka dy vëllezër.
 (E) Unë kam 5 fëmijë.


24. Beni, pasi shkruajti një numër të plotë në rrethin e parë, kreu të gjitha veprimet sipas instruksioneve të skemës:



Sa numra nga rrathët e skemës mund të plotpjesëtohen me 3?

- (A) vetëm një (B) ose vetëm një ose vetëm dy
 (C) vetëm dy (D) ose vetëm dy ose vetëm tre
 (E) ose vetëm tre ose vetëm katër

25. Forma prej letre në figurën e mëposhtme, pasi paloset, formon një kuti me përmasa $2 \times 1 \times 1$.




Cila nga kutitë e mëposhtme nuk mund të jetë ajo e formuara?

- (A) (B) (C)
 (D) (E)


26. Elda u fotografua me 8 kushërinjtë e saj. Secili nga 8 kushërinjtë ka dalë me të në dy ose tre fotografi. Në secilën fotografi ka saktësisht 5 veta. Në sa fotografi doli Elda?

- (A) 3 (B) 4 (C) 5 (D) 6 (E) 7

27. Jeta dhe Shpëtimi po gjuajnë me top dy piramida të njëjta, të ndërtuara secila me 15 kanaçe, si në figurë. Jeta rrëzon 6 kanaçe duke mbledhur 25 pikë. Shpëtimi rrëzon 4 kanaçe. Sa pikë ka mbledhur ai?




Pas gjuajtjes së Jetës



Pas gjuajtjes së Shpëtimit


- (A) 22 (B) 23 (C) 25 (D) 26 (E) 28

28. Çdo shifër e orës dixhitale është e ndërtuar nga të shumtën 7 segmente, si në vijim:



Fatkeqësisht, në çdo bashkësi prej 7 segmentesh, dy segmente të njëjta nuk shfaqen.

Në këto momente ora tregon:



Sa do të tregojë ora pas 3 orësh dhe 45 minutash?

- (A) (B) (C)
- (D) (E)

29. Luani ndërtoi një kub $4 \times 4 \times 4$ duke përdorur 32 kuba të bardhë dhe 32 kuba të zinj $1 \times 1 \times 1$. Ai i vendosi në atë mënyrë që sipërfaqja më e madhe e kubit të tij të ishte e bardhë. Ç'pjesë e sipërfaqes së përgjithshme të kubit të tij është e bardhë?

- (A) $\frac{1}{4}$ (B) $\frac{1}{2}$ (C) $\frac{2}{3}$ (D) $\frac{3}{4}$ (E) $\frac{3}{8}$

30. Zana ka dy makineri: Njëra kthen 1 monedhë të bardhë në 4 monedha të kuqe, ndërsa tjetra kthen një monedhë të kuqe në 3 monedha të bardha. Zana ka 4 monedha të bardha. Pas saktësisht 11 kthimesh ajo do të ketë 31 monedha. Sa prej tyre do të jenë të kuqe?

- (A) 21 (B) 17 (C) 14 (D) 27 (E) 11